



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 582/1 Prot.

Tiranë, më 19.02.2025

VENDIM

Nr. 9 Datë 19.02 2025

**“PËR
MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT ME 50 % PËR
STUDENTËT E CIKLIT TË II QË PLOTËSOJNË KRITERET, PËR VITIN
AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike"; Vendimit të Bordit të Administrimit nr.32 datë 07.08.2024 "Mbi miratimin e tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin Nr. 41 datë 31.10.2024 "Për Miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa shkollimit për ciklin e parë të studimeve, reduktim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Relacionin nr. 365 datë 28.01.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për përjashtim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve", në Relacionin e Administratorit nr.486/1 prot, dt 07.02.2025
Bordi i Administrimit ,


V E N D O S I :

1. Miratimin e listës shtesë të studentëve që ndjekin studimet në Ciklin e Dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025 kriteri 2, tabela bashkëngjitur;
2. Miratimin e listës shtesë të studentëve që ndjekin studimet në Ciklin e Dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025 kriteri 3, tabela bashkëngjitur;

3. Efektet financiare për studentët që kanë aplikuar brenda afateve të përcaktuara fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2024-2025, dhe studentët që kanë aplikuar pas afatit 15.12.2024 llogariten sipas datës së aplikimit.
4. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë dhe me efektet financiare duhet të dërgohet në MAS dhe AKFAL.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, Fakulteti i Shkencave të Levizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit , Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI



Kriteri Nr. 2 Student qe vjen nga shtresa sociale : Student femije te personave /familjes me aftesi te kufizuar , te vertetuar me Vendim te KMC-A per pune , familjet e te cileve trajtohen/perfitojne nga Ligji nr 9355 date 10.03.2015 . Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore te ndryshuar , ndihmen ekonomike te plote apo te pjesshme nga njesite veteqeverisjes vendore .

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot.	Data	Fakultet	Prog	Viti	Efekti Financiar
1	EF813B120023	O. K	149/1	14.01.2025	FSHL	MEFSH	2	52,500
2	EF813B130008	S. H	149	14.01.2025	FSHL	MEFSH	1	52,500
3	EF813B120204	A. M	232	21.01.2025	FSHL	MEFSH	2	52,500
Totali								157,500

Kriteri Nr. 3 Student qe vjen nga shtresa sociale : Studentet qe familjet e te cileve trajtohen/perfitojne ndihme ekonomike te plote apo te pjesshme nga njesite baze te veteqeverisjes vendore .

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot.	Data	Fakultet	Prog	Viti	Efekti Financiar
1	EF813B130188	K. A	149/3	15.01.2025	FSHL	MEFSH	1	52,500
2	EF813B130189	L. A	149/2	15.01.2025	FSHL	MEFSH	1	52,500
Totali								105,000

Eduard Meçaj